VENDIM
Nr. 128, datë 15.11.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "M.T.C. ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "RADOVË"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa "a", nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "M.T.C. Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "M.T.C. Energy" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "M.T.C. Energy" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Radovë".
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti